



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2353/13 prot.

Datë 30.09.2024

V E N D I M

Nr. 1356 / 2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.09.2024 me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Inpress” ShPK, “RAMA-GRAF” ShPK dhe “Dynamicx GROUP” ShPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” shërbime, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-13389-07-17-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Spitalin Rajonal Elbasan”, me fond limit 2,213,173 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.07.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “KRISTALINA KH” ShPK, me Nipt K11501002D, Adresa: Rr. “Lord Bajroni”, Laprakë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
Blv “Dëshmorët e Kombit” Nr.3, 1001 Tiranë

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Inpress” Sh.P.K, me Nipt L52122014L, Adresa: Rr. “Siri Kodra”, Ish blloku i magazinave të tregtisë, Tiranë.

Operatori ekonomik "RAMA-GRAF" Sh.P.K, me Nipt K42701205E, Adresa: Lagjja Kongresi Elbasanit, Rr. "Dhimitër Xhuvani", Z. kadastrale nr.8521, pasuria nr.4/70, kati I, Elbasan.

Operatori ekonomik "Dynamicx GROUP" ShPK, me Nipt L42306022T, Adresa: Z. kadastrale 3183, Nr. Pasurie 30/13, Rinas, Krujë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.07.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-13389-07-17-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Spitalin Rajonal Elbasan”, me fond limit 2,213,173 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.07.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

II.2. Në datën 30.07.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 06.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi renditjen e pjesëmarrësve me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “FILARA” ShPK	Vlera e ofertës	1,350,000	lekë	skualifikuar
2. “Inpress” ShPK	“	1,593,490	“	kualifikuar
3. “RAMA - GRAF” ShPK	”	1,662,090	“	kualifikuar
4. “Dynamicx GROUP” ShPK	“	1,860,100	“	kualifikuar
5. “KRISTALINA KH” ShPK	“	1,964,320	“	kualifikuar

II.4. Autoriteti Kontraktor më datë 15.08.2024, ka publikuar në SPE Njoftim Fituesi Paraparak.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4471, datë 20.08.2024 dhe me Nr. 2353/2024 Prot., datë 20.08.2024 e operatorit ekonomik “KRISTALINA KH” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-13389-07-17-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Spitalin Rajonal Elbasan” me fond limit 2,213,173 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura

nga operatorët ekonomikë “Inpress” ShPK, “RAMA-GRAF” SHPK dhe “Dynamicx GROUP” SHPK, në procedurën sipër cituar.

II.5.1. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formulari i publikimit Nr. 2353/2 Prot., datë 21.08.2024.

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Inpress” ShPK, “RAMA-GRAF” SHPK dhe “Dynamicx GROUP” SHPK.

II.6. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr.704/10 prot., datë 30.08.2024, protokolluar më tonën me nr. 2353/6, datë 02.09.2024, me objekt “Dërgim Vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “KRISTALINA KH” ShPK, KSHA ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.7. Në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, operatori ekonomik “**Inpress**” SHPK ka paraqitur online, “**Formularin e paraqitjes së argumenteve**”, datë 21.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 2353/3, datë 21.08.2024, duke argumentuar, se pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë:

“Inpress” SHPK ka përmbushur kriteret me paraqitjen e dokumenteve në SPE dhe në formë shkresore ditën e hapjes së ofertave. Një kopje të njehsuar me origjinalin, në formë shkresore, dokumentacioni ligjor dhe teknik paraqitur në datën 07.08.2024.

Kërkojmë lënien në fuqi të vendimit të KVO-së,

II.8. Në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, operatori ekonomik “RAMA-GRAF” SHPK ka paraqitur online, “Formularin e paraqitjes së argumenteve” datë 22.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 2353/4, datë 23.08.2024, si edhe ardhur në formë shkresore, protokolluar me tonën me nr. 2353/5, datë 26.08.2024 duke argumentuar se:

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë,

si edhe ngre:

Pretendime për operatorin ekonomik “KRISTALINA KH” SHPK, për mospëmbushje të kriterit 2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt - prokurimi, si më poshtë:

- a) 1 (një) përgjegjës shërbimi,*
- b) 1 (një) punonjës grafik- dizajner*
- c) 2 (dy) punonjës ndihmës.*

Pretendime për operatorin ekonomik “Inpress” SHPK për mospëmbushje të kriterëve:

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- Makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm; 2 (dy) copë
- Makinë qepëse 2 (dy) copë
- Makinë celefoni; 2 (dy) cope

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt - prokurimi, si më poshtë:

- a) 1 (një) përgjegjës shërbimi,
- b) 1 (një) punonjës grafik- dizajner
- c) 2 (dy) punonjës ndihmës.

II.9. Me shkresën nr. 704/10 prot, datë 30.08.2024, me objekt *Informacion*, protokolluar me tonën me nr. 2353/6, datë 02.09.2024, autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “KRISTALINA KH” SHPK, duke vendosur refuzimin e ankesës.

[...]1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi kualifikimin e OE. “Inpress” SHPK, Autoriteti kontraktor pasi mori në shqyrtim ankesën dhe nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE si edhe te paraqitur në formë shkresore sipas përcaktimeve në nenin26 te LPP-së i ndryshuar, nga operatori ekonomik “**Inpress**” SHPK, konstatohet se nga ana e këtij të fundit është paraqitur dokumentacioni që vërteton se përmbush kriteret e vendosur në dokumentet e tenderit... Për sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

2.Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi kualifikimin e OE “RAMA-GRAF” SHPK dhe “Dynamicx GROUP” SHPK, KSHA gjykon se për sa kohë pretendimet për OE “Inpress” SHPK nuk qëndrojnë dhe ky operator do të mbetet i kualifikuar , trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me OE “RAMA-GRAF” SHPK dhe “Dynamicx GROUP” SHPK nuk ka ndikim mbi rezultatin e çështjes

KSHA vendos : Refuzimin e ankesës. [...]

Bashkëlidhur Vendimit të KSHA-së, autoriteti kontraktor ka përcjellë dokumentet provuese të operatorit ekonomik “Inpress” SHPK.

II.10. Referuar pretendimeve të ankimuesit, si edhe dokumentacionit të procedurës së prokurimit, Komisioni, me Vendimin e Ndërmjetëm me Nr.1200/2024, Datë 09.09.2024, vendosi:

1. Të urdhërojë paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, nga ana e shoqërive “RAMA-GRAF” SHPK dhe “Dynamicx GROUP” SHPK në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-13389-07-17-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Spitalin

Rajonal Elbasan”, me fond limit 2,213,173 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

2. *Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 13.09.2024.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.10. Operatori ekonomik “RAMA-GRAF” SHPK, me shkresën datë 12.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2353/10, datë 13.09.2024, me objekt: Lista e dokumenteve të dorëzuara, ka përcjellë pranë Komisionit, dokumentet provuese të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “KRISTALINA KH” ShPK, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “RAMA GRAF” ShPK me pretendimet si vijon:

-Kemi bindjen se operatorët ekonomikë “RAMA GRAF” ShPK nuk disponon makineritë, kjo krijon një hendek të rëndësishëm në kapacitetin e tyre për të përmbushur detyrimet e kontratës si edhe një deklaram të rremë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për disponimin e këtyre makinerive.

Ndaj kërkojmë nga AK dhe KPP verifikimin e faturave/kontratave të qirase të të gjitha makinerive të deklaruara nga keta OE që të korrespondojnë me pershkrimin dhe formatin e kërkuar.

2.3.2. *Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:*

- *Makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm; 2 (dy) copë*
- *Makinë qepëse 2 (dy) copë*
- *Makinë telefoni; 2 (dy) cope*

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

-Kemi bindjen se operatorët ekonomikë “RAMA GRAF” ShPK nuk disponon personelin e kërkuar në kriter. Duke marrë parasysh volumin e punës si edhe makineritë e specifikuar në këtë procedurë prokurimi ,të cilat janë të avancuara dhe me kapacitet të lartë prodhimi, kërkojnë jo vetëm personel të kualifikuar por edhe një numër të mjaftueshëm të tyre. Këta operatorë ekonomik nuk kanë paraqitur provat e nevojshme që konfirmojnë punësimin e një përgjegjësi shërbimi, një punonjës grafik dhe dy punonjësve ndihmës qe do të jenë të dobishëm për këtë procedurë prokurimi.

Kërkojmë nga AK dhe KPP verifikimin e kontratave te punes dhe nese kontratat e punes korrespondojne me deklarimin ne listepagesen prane administrates tatimore.

2.3.3 *Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:*

- a) 1 (një) përgjegjës shërbimi,*
- b) 1 (një) punonjës grafik- dizajner*
- c) 2 (dy) punonjës ndihmës.*

Për punonjësit në pikat a dhe c duhet të paraqitet: kontratë pune, të vlefshme.

Për punonjësën në pikën b duhet të paraqitet:

- diplomë e shkollës së lartë dhe/ose Dëshmitë e aftësisë profesionale, sipas Ligjit Nr.15/2017, ”Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar, që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit;*
- kontratë pune, të vlefshme*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor

III.1.1. Autoriteti kontraktor me shtojcën 8, FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.3 Kapaciteti teknik, ka kërkuar:

2.3.2. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- Makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm; 2 (dy) copë
- Makinë qepëse 2 (dy) copë
- Makinë telefoni; 2 (dy) cope

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet: dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt - prokurimi, si më poshtë:

- a) 1 (një) përgjegjës shërbimi,
- b) 1 (një) punonjës grafik- dizajner
- c) 2 (dy) punonjës ndihmës.

Për punonjësit në pikat **a** dhe **c** duhet të paraqitet: kontratë pune, të vlefshme.

Për punonjësin në pikën **b** duhet të paraqitet:

- diplomë e shkollës së lartë dhe/ose Dëshmitë e aftësisë profesionale, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar, që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit;
- kontratë pune, të vlefshme

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.1.2. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, përcaktohet se:

"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një

procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.3. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.5. Në nenin 40, pika 5 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.1.6. Autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “KRISTALINA KH” SHPK, duke vendosur refuzimin e ankesës.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit publik me Vendimin Nr.1200/2024, Datë 09.09.2024 vendosi:

1. Të urdhërojë paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, nga ana e shoqërive “RAMA-GRAF” SHPK dhe “Dynamicx GROUP” SHPK në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-13389-07-17-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Spitalin Rajonal Elbasan”, me fond limit 2,213,173 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.
2. Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 13.09.2024.

III.1.8. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik RAMA GRAF SHPK, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë me shkresën më datë 12.09.2024, protokolluar me nr. 2353/10, datë 13.09.2024, konstatoi se:

Operatori ekonomik ka paraqitur në formë shkresore dokumentacionin e ofertës gjithsej 119 faqe, të noterizuara. Referuar dokumenteve Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterëve për kualifikim, 2.3.2 dhe 2.3.3 (për të cilat ankimuesi ngre pretendime) janë paraqitur dokumentet si vijon:

- 1 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, i plotësuar në të gjitha fushat, i firmosur dhe vulosur. Operatori ka deklaruar personel prej 9 punonjësish dhe 6 makineri.
- 2 **Në përmbushje të kriteri 2.3.2.**
 - 1 (një) **përgjegjës shërbimi**, Znj. N. B, shoqëruar me dokumentin
-Kontratë Individuale Pune datë 06.01.2016 pa afat. Firmosur dhe vulosur nga palët dhe noterizuar.
 - 1 (një) **punonjës grafik- dizajner**, Z. S. J, shoqëruar me dokumentet:
-Dëshmi të aftësisë profesionale, dokumenti Certifikatë Nr. 9425 datë 01.8.2021 për Graphic Design.
-Kontratë Individuale Pune datë 06.01.2016 pa afat. Firmosur dhe vulosur nga palët dhe noterizuar.
 - 2 (dy) **punonjës ndihmës.**
 - Z. K. D. - Kontratë Individuale Pune datë 06.11.2016 pa afat. Firmosur dhe vulosur nga palët dhe noterizuar.
 - Znj. M. D. - Kontratë Individuale Pune datë 06.01.2016 pa afat. Firmosur dhe vulosur nga palët dhe noterizuar.

3. **Në përmbushje të kriteri 2.3.3 ka paraqitur:**

- Deklarate doganore, Nr. 1745, date 26.07.1997 shitës Litogafia Bodiniana SRL, Emilia BO, Itali Blerës RAMA GRAF SHPK.
Makinë Shtypi Offset 50x70 - copë 1
Makinë Qepëse - copë 1
Makinë Zhvillimi Lastre, 3 koli 2130 Kg (e noterizuar)

- Faturë Tatimore Shitje me Nr. 10, date 28.04.2021, Nr. i Serisë 15795554, Shitës Fadil Imeraj dhe Blerës RAMA GRAF SHPK,
Makinë Shtypi Offset 50x70 copë 1, firmosur dhe vulosur,

- Faturë Tatimore Shitje me Nr. 610, date 03.05.2018, Nr. i Serisë 41213693, Shitës Dita Print ShPK dhe Blerës RAMA GRAF SHPK,
Makinë Celofonimi copë 1

- Faturë Tatimore Shitje me Nr. 216, date 06.05.2021, Nr. i Serisë 98378266, Shitës AlbEmilia ShPK dhe Blerës RAMA GRAF SHPK,
Makinë Qepëse copë 1
Makinë Celofonimi copë 1

Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik si dhe verifikimi i dokumentacionit në formë shkresore, dorëzuar pranë KPP-së nga operatori ekonomik "RAMA GRAF" ShPK, Komisioni konstatoi, se ky i fundit, në përmbushje të kriterëve të mësipërme, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar me anë të cilit vërteton disponimin e personelit dhe pajisjeve e makinerive të kërkuara.

III.1.9. Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit sa i takon punonjësve të kërkuar, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Prokurimit Publik, referuar fakteve në formë shkresore, paraqitur nga “RAMA GRAF” ShPK, të cilat përputhen me dokumentet e ofertës depozituar në SPE, gjykon, se operatori ekonomik përmbush kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, duke paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të plotësuar në të gjitha fushat dhe të firmosur dhe vulosur nga personi përgjegjës. Gjithashtu, në përmbushje të kriterëve kualifikuesë 2.3.2 dhe 2.3.3, mbi disponimin e makinerive dhe personelin teknik të kërkuar për këtë procedurë prokurimi, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentet provuese të rregullta, të firmosura dhe vulosura nga palët si edhe të noterizuara.

Për sa referuar pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “KRISTALINA KH” ShPK, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Dynamicx GROUP*” ShPK me pretendimet si vijon:

[...]-Kemi bindjen se operatori ekonomik nuk disponon makineritë kjo krijon një hendek të rëndësishëm në kapacitetin e tyre për të përmbushur detyrimet e kontratës si edhe një deklaram të rremë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për disponimin e këtyre makinerive.

Ndaj kërkojmë nga AK dhe KPP verifikimin e faturave/kontratave të qirasë të të gjitha makinerive të deklaruara që të korrespondojnë me përshkrimin dhe formatin e kërkuar.

Kemi bindjen se nuk disponon personelin e kërkuar në kriter. Duke marrë parasysh volumin e punës si edhe makineritë e specifikuar në këtë procedurë prokurimi ,të cilat janë të avancuara dhe me kapacitet të lartë prodhimi, kërkojmë jo vetëm personel të kualifikuar por edhe një numër të mjaftueshëm të tyre. Këta operatorë ekonomik nuk kanë paraqitur provat e nevojshme që konfirmojnë punësimin e një përgjegjësi shërbimi, një punonjes grafik dhe dy punonjësve ndihmes që do të jenë të dobishëm për këtë procedurë prokurimi.

Kërkojmë nga AK dhe KPP verifikimin e kontratave të punës dhe nëse kontratat e punës korrespondojnë me deklaramin në listepagesen pranë administratës tatimore.[...]

Me shkresëm nr. 704/10 prot, datë 30.08.2024, me objekt “Informacion”, protokolluar me tonën me nr. 2353/6, datë 02.09.2024, autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “KRISTALINA KH” SHPK, duke vendosur refuzimin e ankesës.

Komisioni i Prokurimit publik, për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, me Vendimin e Ndërmjetëm me Nr.1200/2024, datë 09.09.2024, vendosi:

1. *Të urdhërojë paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, nga ana e shoqërive “RAMA-GRAF” SHPK dhe “Dynamicx GROUP” SHPK në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-*

13389-07-17-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Spitalin Rajonal Elbasan”, me fond limit 2,213,173 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

- 2. Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 13.09.2024.*

Referuar sa më sipër, Komisioni vëren, se Vendimi i sipërcituar i KPP-së, iu është bërë i ditur palëve, nëpërmjet publikimit në sistemin e ankesave elektronike, si edhe është përcjellë në formë shkresore me anë të postës drejtuar operatorëve ekonomikë të interesuar.

Gjithashtu, Komisioni vëren, se nga publikimi i Vendimit, kanë kaluar mbi dy javë dhe operatori ekonomik i interesuar në këtë procedurë “Dynamicx GROUP” SHPK, nuk ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar me Vendimin e Ndërmjetëm Nr. 1200/2024 datë 09.09.2024 (sipërcituar dispozitivi).

Për sa referuar më sipër, Komisioni gjykon, se për sa kohë operatori ekonomik nuk bashkëpunoi me KPP-në për dërgimin e dokumenteve provuese të ofertës së tij në procedurën objekt - shqyrtimi, Komisioni nuk e ka të mundur që të kryejë vlerësimin e dokumenteve të operatorit ekonomik “Dynamicx GROUP” SHPK objekt - ankimi nga operatori “KRISTALINA KH” SHPK.

Për sa më sipër, Komisioni nuk do t’i marrë në shqyrtim dokumentet e operatorit ndaj gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Dynamicx GROUP” SHPK do të mbetet e njëjtë.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “KRISTALINA KH” SHPK, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik **“Inpress” SHPK**, Komisioni gjykon të mos i marrë në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik **“RAMA-GRAF” SHPK**, nuk do të ndryshojë, duke mbetur të kualifikuar edhe pas Vendimit të KPP-së, pra renditja dhe gjendja e operatorëve ekonomikë do të mbetet e njëjtë.

Për sa referuar më sipër, ankimuesi nuk do të mund të shpallet fitues i kontratës objekt - prokurimi, duke qenë se renditja përfundimtare do të jetë e njëjtë, ku para tij qëndrojnë tre operatorë ekonomikë të kualifikuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 pika 1 dhe 3 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “KRISTALINA KH” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar’ shërbime, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-13389-07-17-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Spitalin Rajonal Elbasan”, me fond limit 2,213,173 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.07.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KRISTALINA KH” ShPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

